# Drive

PORSCHE
ALBANIA

06/13


Një kohë e re
A new era
F/Pg. 6

E ardhmja ka mbërritur
The future is here
F/Pg. 8

Porsche Albania i uron mirëseardhjen Porsche Leasing / Porsche Mobility!
Porsche Albania welcomes Porsche Leasing / Porsche Mobility to the team!
F/Pg. 10

Lidhu! Ke vetëm një jetë
Click it! You only have one life
F/Pg. 16




# **Drive** 06/13
with us




## **Përmbajtja** - Contents


• 03 **I DASHUR LEXUES** - DEAR READER

• 04 **PËRMBLEDHJE E STRUKTURËS SË RE TË MENAXHIMIT TË PHS-SË** - OVERVIEW OF THE NEW PHS MANAGEMENT STRUCTURE

• 06 **NJË KOHË E RE** - A NEW ERA

• 08 **E ARDHMJA KA MBËRRITUR** - THE FUTURE IS HERE

• 09 **VOLKSWAGEN FESTON PRODHIMIN E GOLF-IT TË 30 MILIONTË** - VOLKSWAGEN CELEBRATES THE 30 MILLIONTH GOLF

• 10 **PORSCHE ALBANIA I URON MIRËSEARDHJEN NË GRUP KOMPANIVE TË REJA PORSCHE LEASING / PORSCHE MOBILITY!** - PORSCHE ALBANIA WELCOMES PORSCHE LEASING / PORSCHE MOBILITY TO THE TEAM!

• 11 **TASHMË NË SHQIPËRI** - NOW IN ALBANIA

• 14 **AUDI A3 SEDAN, HYRJA NË NJË SEGMENT TË RI TË TREGUT** - AUDI A3 SEDAN, LAUNCH INTO A NEW MARKET SEGMENT AUDI A3 SEDAN,

• 16 **LIDHU! KE VETËM NJË JETË BELT UP!** - CLICK IT! YOU ONLY HAVE ONE LIFE.

• 20 **EMOCION ME SEAT LEON.** - EMOTION WITH SEAT LEON.

• 22 **PARTNERITET I VAZHDUESHËM** - A CONTINUOS PARTNERSHIP

• 23 **NJË TAKSI TË LUTEM** - TAXI PLEASE!

• 24 **PILOTI I ŠKODA-S KOPECKÝ FITON RALLY-N E AZOREVE** - ŠKODA DRIVER KOPECKÝ WINS RALLY AZORES

• 26 **CADDY CROSS SPECIAL EDITION** - CADDY CROSS SPECIAL EDITION



Revista Drive është një botim periodik i Porsche Albania.

Realizimi: Botues Porsche Albania, Realizimi grafik: Euro RSCG Tirana, Albania.

Burimi: Audi: Audi-Mediaservice.com,
SEAT: media.seat.com,
VW Makina Tregtare: volkswagen-media-services.com,
Skoda: press.skoda-auto.com.
Servisi: Database i Porsche Albania-s.



Për komente, pyetje apo sygjerime ju lutem na kontaktoni në office@porsche.al ose në numrin e telefonit: +355 (04) 240 74 30.

Porsche Albania,
Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 3, Mëzez.
Telefon: +355 (04) 240 74 30 , Fax.: +355 (04) 240 74 34,
e-mail: office@porsche.al; http://www.porsche.al


8


9


14



20


23


26

# I dashur lexues,

Fundi i muajit prill shënon fillimet e kompanisë sonë simotër Porsche Leasing, e cila tashmë plotëson gamën e shërbimeve që Porsche Albania ofron për të gjithë klientët e saj. Ajo çka e bën këtë nismë të rëndësishme është zgjidhja e plotë që marrin klientët tanë në një vend të vetëm, në sallonin e Porsche Albania. Por fillimi i aktivitetit të Porsche Leasing mbart edhe një simbolikë tjetër që merr një kuptim të veçantë në këtë periudhë sfiduese që po kalon tregu i makinave të reja në Shqipëri.

Prezantimi i Porsche Leasing është ilustrimi më i mirë që ne mund të japim për sa i përket politikës që Porsche Albania ndjek në këtë periudhë të vështirë, ku përfshihet përmirësimi i vazhdueshëm i procedurave dhe zgjerimi i gamës së shërbimeve në funksion dhe favor të klientëve tanë.

Për ne, të operosh në një vend, nuk do të thotë vetëm të angazhohesh në nisma biznesi, por gjithashtu edhe të kontribuosh për të përmirësuar një tipar të këtij vendi. Ky ishte edhe qëllimi i projektit “Lidhu!” i mbështetur nga Porsche Albania, ku nëpërmjet një zinxhiri seminaresh në universitete publike dhe private u synua të ndërgjegjësohej brezi i ri mbi rëndësinë e vendosjes së rripit të sigurimit në çdo udhëtim.

Komunikimi dixhital, risitë nga bota e makinave, prezantimet me grupet e interesit janë disa nga çështjet e tjera mbi të cilat mund të lexoni më tepër në faqet në vijim.

Lexim të mbarë.

**Dorian Mehmeti**
**Drejtor Marketingu në Porsche Albania**

# Dear reader,

The end of April marks the launch of our sister company Porsche Leasing, which now complements the range of services that Porsche Albania offers to all its customers. What makes this initiative so important is the fact that our customers receive a complete solution in one single place, the Porsche Albania showroom. However, the start of operations by Porsche Leasing is also symbolic in that it takes on a special meaning in these challenging times affecting the new car market in Albania.

The launch of Porsche Leasing is the best illustration that we can give of the policy pursued by Porsche Albania throughout these tough times, a policy that covers the continuous improvement of procedures and the expansion of the range of services, in line with and to the benefit of our customers.

To us, conducting business in a country does not only mean committing to business initiatives, but also making our contribution to improving an aspect of that country. This was the aim of the “Click it!” project supported by Porsche Albania, a project which, through a series of seminars held at state and private universities aimed to raise awareness within the younger generation of the importance of fastening seat belts on each and every trip.

Digital communication, innovations in the world of cars and presentations with interest groups are some of the other issues you can read more about in the following pages.

Enjoy reading your Drive Magazine

**Dorian Mehmeti**
**Marketing Director at Porsche Albania**

# Përmbledhje e strukturës së re të menaxhimit të PHS-së

## Overview of the new PHS management structure

Që nga prilli 2013 Porsche Holding Salzburg (PHS) ka krijuar një strukturë e re menaxhimi. Më 1 prill Rainer Schroll është caktuar në grupin drejtues. Kurt Loidl u largua nga drejtimi i PHS-së me kërkesën e tij.

PHS vazhdon të jetë e strukturuar në katër fusha të veçanta biznesi. Megjithatë përgjegjësitë e menaxhimit janë riorganizuar disi: Rainer Schroll është përgjegjës për shitjet në Gjermani dhe Spanjë si edhe Porsche Informatik, gjë që duhet të përbëjë një sfidë të konsiderueshme për të. Alain Favey mbetet në pozicionin e zëdhënësit të drejtorisë dhe vazhdon të jetë përgjegjës për shitjen me shumicë, përfshirë veprimtaritë në Amerikën e Jugut dhe markën Porsche në Austri. Johannes Sieberer do të jetë përgjegjës për veprimtaritë e shitjes me pakicë të Porsche Inter Auto (Austri, Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Itali) dhe për veprimtaritë e PHS-së në Kinë. Detyra e Dr. Hans-Peter Schützinger nuk ka ndryshuar; ai vazhdon të jetë përgjegjës për shërbimet financiare dhe PGA-në.

Pas tre dekadash me PHS-në, Kurt Loidl largohet nga grupi drejtues me kërkesën e tij. I ardhur nga Bad Ischl, Austri, Loidl ka qenë me kompaninë tonë që nga viti 1985 dhe është bërë pjesë e grupit drejtues që nga viti 1999. Ai ka luajtur një rol kyç në zgjerimin e veprimtarive të shitjes me pakicës në Austri dhe në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, markës dhe biznesit të makinave sportive Porsche duke përfshirë Bentley dhe Lamborghini. Gjatë kohës që kaloi me PHS-në, 52 vjeçari gjithashtu i dha shtysë veprimtarive të shitjeve me pakicë në Kinë dhe të Porsche Informatik. Pasi të qëndrojë një kohë të shkurtër larg kompanisë, ai do të marrë përgjegjësi të reja në Volkswagen Group.

A new management structure has been in place at Porsche Holding Salzburg (PHS) since 1 April 2013. Rainer Schroll was appointed to the management team as of 1 April. Kurt Loidl departs from PHS' management at his own request.

PHS continues to be structured as four separate business fields. However, management responsibilities have been reshuffled somewhat: Rainer Schroll is now responsible for Retail in Germany and Spain as well as Porsche Informatik, which should represent a significant challenge for him (see interview on page 12). Alain Favey remains in the position of spokesman for the management and continues to be responsible for Wholesale, including activities in South America and the Porsche marque in Austria. Johannes Sieberer will be responsible for Porsche Inter Auto retail activities (Austria, CEE and Italy) and for PHS' China operations. Dr. Hans-Peter Schützinger's remit remains unchanged; he continues to be responsible for Financial Services and PGA.

After some three decades at PHS, Kurt Loidl departs from the management team at his own request. Hailing from Bad Ischl, Austria, Loidl has been at the company since 1985 and part of the management since 1999. He played a pivotal role in expanding retail operations in Austria and CEE countries, the Porsche sportscar marque and business involving Bentley and Lamborghini. During his time at PHS, the 52-year-old also drove forward the development of retail activities in China and of Porsche Informatik. After a short time away from the company, he will assume new responsibilities in the Volkswagen Group.



**Alain Favey (Zëdhënës)** *(spokesman)*

**Shitjet me shumicë** *Wholesale*

- Shitjet me shumicë, Austri (Porsche Austria përfshirë Porsche Sportwagen, Intercar, Allmobil) *Wholesale Austria (Porsche Austria incl. Porsche Sport - wagen, Intercar, Allmobil)*
- Shitjet me shumicë jashtë shtetit, përfshirë Amerikën e Jugut *Wholesale Abroad, incl. South America*
- Porsche Constructions *Porsche Constructions*
- Auto-Z *Auto-Z*
- Agjencia Publicitare Porsche *Porsche Advertising Agency*
- Marrëdhëniet me publikun *Public Relations*
- Personeli *Personnel*



**Rainer Schroll**

**Shitjet me pakicë dhe sistemet në Volkswagen Group** *Volkswagen Group Retail & Systems*

- Volkswagen Group Retail Germany VGRD *Volkswagen Group Retail Germany VGRD*
- Volkswagen Group Retail Spain VGRS *Volkswagen Group Retail Spain VGRS*
- Porsche Informatik *Porsche Informatik*



**Johannes Sieberer**

**Shitjet me shumicë PIA dhe Kinë** *Wholesale PIA and China*

- PIA Retail Österreich *PIA Retail Österreich*
- PIA Retail Europa Qendrore dhe Lindore, *PIA Retail CEE,*
- Poloni dhe Itali *Poland and Italy*
- Shitjet me pakicë në Kinë *Retail China*
- Shitje e drejtpërdrejtë e makinave ekskluzive *Direct Retail Exclusive Cars*



**Hans-Peter Schützinger**

**Shërbimet Financiare** *Financial services*

- Porsche Bank *Porsche Bank*
- Porsche Insurance *Porsche Insurance*
- Porsche Corporate Finance *Porsche Corporate Finance*
- Porsche Real Estate *Porsche Real Estate*
- ARAC/Europcar *ARAC/Europcar*
- Grupet financiare Porsche jashtë shtetit *Porsche Finance Groups Abroad*
- Auditi *Auditing*
- Departamenti i financës së grupit *Group Finance*

**Multi-brand world** *Multi-brand world*

- *PGA Motors France*
- *PGA Motors Poland*
- *PGA Netherlands*

**Struktura e Porsche Holding që nga data 1 prill 2013**

***Structure of Porsche Holding from 1 April 2013***




Ekspertët automobilistikë të Europës janë në një mendje:
Golf i ri është makina e vitit 2013 sepse edhe në
gjeneratën e 7 të tij ky model vendos sërish standarte.
Volkswagen JU thotë faleminderit! Pa të gjithë JU
nuk do të kishim mundur të krijonim këtë makinë.

Das Auto.

Konsum i kombinuar l/100 km: ndërmjet 5,2 dhe 3,8, Emetimet e kombinuara të $CO_2$ në g/km ndëmjet 122 dhe 99.

# Një kohë e re
## A new era



**Gentian Bushati**
Drejtorin e Përgjithshëm të Porsche Albania / General Manager at Porsche Albania

Të nderuar miq, partnerë e klientë të Porsche Albania. Ja ku u takuam në gjysmën e dytë të këtij viti në numrin e parë për vitin 2013 të revistës sonë "Drive".

Kemi folur shpesh për problematikën e tregut të makinave të reja dhe të tregut automobilistik në përgjithësi. Mënyra sesi ky treg po zhvillohet, të bën të ndalesh dhe të mendosh se cilët janë faktorët që ndikojnë në këtë zhvillim.

Viti 2012 u mbyll me rreth 2000 makina të reja të shitura nga operatorët tregtarë të kësaj industrie të ekonomisë shqiptare dhe rreth 54 000 makina të përdorura.

Një problematikë (them kështu, sepse disproporcioni makinave të reja me ato të përdorura nuk është normal dhe i krahasueshëm me asnjë vend të rajonit apo aq më shumë me atë të vendeve të zhvilluara) kjo e ndikuar nga vështirësitë ekonomike të kontinentit të vjetër evropian, por jo rrallë edhe nga legjislacioni në fuqi, që në Shqipëri kthehet në faktorin bazë të këtij rezultati. Shembujt më të fundit të ndikimit që ky legjislacion ka mbi këtë sektor të ekonomisë janë ligji në fuqi që prej shtatorit 2011, si dhe ligji i ri i aprovuar para pak kohësh për përgjysmimin e taksës së qarkullimit për makina e vjetra. Sot, pak javë pas këtij ndryshimi shohim sesi importi i makinave të përdorura ka pësuar një rritje të konsiderueshme. Kjo bën që fokusi i kompanisë

Dear friends, partners and customers of Porsche Albania. Here we are in the second half of this year with the first 2013 edition of our "Drive" magazine.

We have often spoken about the issues that the new car market and the automotive market in general have been facing. The way in which this market is developing gives pause for thought as to what the factors behind these dynamics are.

The end of 2012 marked the sale of about 2,000 new cars by commercial operators in this specific industry of the Albanian economy, and about 54,000 used cars.

This dilemma (I say this, since the disproportionate ratio of new cars to used cars is neither normal nor comparable with any other country of the region, and even less so compared with developed countries) has been influenced by the economic hardship of the old continent of Europe, and to no small degree by current legislation, which in Albania is becoming the key factor behind this. Amongst the most recent examples of the impact that this legislation has on this sector of the economy, are the law in force as of September 2011 and the recently adopted new law that further reduced road tax for old cars by half. Today, only a few weeks after this amendment was approved, we

sonë të riadresohet edhe në këtë treg me anë të markës sonë më të re të tregtimit të makinave të përdorura Weltauto. (www.weltauto.al)

Është e kuptueshme që Shqipëria ka nevojë të theksuar për mobilitet sidomos në rastin kur transporti kombëtar publik është pothuajse i shkatërruar, por efekti i tregut të makinave të përdorura në ekonomi eliminon të mirën e përbashkët që vjen si rrjedhojë e përmirësimit të performancës ekonomike të këtij sektori. Pse e them këtë? Në vitin 2012, rreth 300 milion Euro kanë dalë jashtë vendit për blerje të automjeteve të përdorura nga individë kryesisht të lënë jashtë sistemit fiskal për sa i përket taksimit për rishitjen e këtyre mjeteve. E dyta, mesatarja e moshës së këtyre makinave kalon atë të 15 viteve, gjë që bën që këto makina që sot qarkullojnë pranë banesave, institucioneve apo dhe në rrugët kombëtare, jo vetëm të kenë norma më të larta ndotjeje, por të sjellin edhe risqe të tjera të lidhura me amortizimin. Janë të shumta rastet e aksidenteve në Shqipëri dhe jo gjithmonë për faj të drejtuesit, por edhe të automjetit. Gjithashtu, makinat e vjetra janë etiketuar shpesh si “duhani” i mushkërive të planetit. Një makinë e vjetër ka një normë të çlirimit të CO2 disa herë më të lartë ndotjeje sesa një makinë e prodhuar vitet e fundit. Për këtë arsye, Organizata Botërore e Shëndetësisë u detyrua të bënte riklasifikimin e grimcave të emetuara nga motorët e naftës EURO3 (e poshtë) nga “potencialisht kancerogjene” në “kancerogjene” (International Agency for Research on Cancer – WHO).

Prej afro 8 vitesh Porsche Albania ka qenë gjithmonë pranë blerësve potencialë dhe atyre ekzistues me një nivel të lartë shërbimi, si në shitje, ashtu edhe në pas shitje për të ruajtur një nivel të lartë kënaqësie të klientëve tanë që ne i konsiderojmë partnerë të mirëfilltë. Përgjegjshmëria profesionale që na karakterizon dhe profesionalizmi i skuadrës që unë së bashku me kolegun tim z. Jungnitsch drejtojmë, na bën të jemi optimistë edhe për pjesën e dytë të këtij viti, pavarësisht ashpërsimit të situatës ekonomike në vend, terrenit aspak të favorshëm si rrjedhojë e ndryshimeve të shpeshta dhe mospërfshirjen në vendimmarrje të aktorëve të tregut, si dhe të taksave që ndikojnë direkt në performancën e këtij tregu.

Ne kemi shtuar më tej markat që ne përfaqësojmë. Kemi një partner shumë serioz dhe me eksperiencë ndërkombëtare dhe disa dhjetravjeçare, siç është kompania simotër Porsche Leasing. Kemi një rrjet shitjesh dhe shërbimesh tek distributorët tanë në qytetet kryesore të Shqipërisë, si në Shkodër, Tiranë Fier dhe Gjirokastër. Jemi në gjendje të përshtatim ofertat tona, atë të shitjes dhe të passhitjes, si dhe skemave të financimit të tyre sipas interesave dhe dëshirave të partnerëve tanë. Kemi aftësi të konkurrojmë në tendera të ndryshëm duke ofruar produktet më të mira me çmimin më të mirë; jemi pjesë e një kompanie me rrjetin më të madh të shpërndarjes në Evropë siç është Porsche Holding. Portofoli i produkteve tona përbëhet nga markat më në zë të grupit të mirënjohur Volkswagen, dhe me krenari them që Porsche Albania ka stafin më të përgatitur e më të suksesshëm në tregun automobilistik në Shqipëri.

Janë këto vlera që ne në Porsche Albania na bëjnë besimplotë që pozitat kryesuese në tregun automobilistik në Shqipëri të forcohen jo vetëm sepse ne duam të jemi zgjedhja juaj e parë, por sepse ne besojmë në partneritetin e ngritur tashmë, në aftësinë që së bashku të plotësojmë kërkesat për produkte cilësore të përshtatshme për ju, të cilat ne jua sjellim në një paketë të vetme suksesi: makinë + financim + regjistrim + servis.

Gjithashtu, rruga evropiane që Shqipëria ka nisur tashmë na bën optimistë se jo vetëm legjislacioni i ri do të jetë më i favorshëm ndaj makinave të reja, por edhe përfitimet e qytetarëve do të jenë disa herë më të mëdha.

Ju uroj pushime verore sa më të bukura!

can observe significant growth in the import of used cars. This trend has led our company to revise its focus on this market too, by trading in our newest brand of used cars, Weltauto. (www.weltauto.al)

It goes without saying that Albania is in dire need of mobility, especially given that national public transport is almost totally non-functional, but the impact of used cars on the economy eliminates the common good deriving from the improvement in the economic performance of this sector. Why do I say this? Firstly, in 2012, the country was left out of pocket by approximately 300 million Euros due to used buyers who are largely untouched by the fiscal system when it comes to taxation for the resale of these vehicles. Secondly, these cars are on average over 15 years old, meaning that when they are driven today near residential areas, institutions and national roads, they not only have higher pollution rates but also generate other risks associated with wear and tear. Cases of accidents in Albania are numerous and they are not always due to the driver’s fault, but also due to the car’s condition. What is more, old cars have often been described as “tobacco” to the lungs of the planet. An old car has a CO2 emission rate several times higher than a car manufactured in recent years. This is the reason why the World Health Organisation was forced to reclassify exhaust diesel emissions by EURO3 (and lower) diesel engines from “potentially carcinogenic” to “carcinogenic” (International Agency for Research on Cancer – WHO).

For about eight years now Porsche Albania has consistently offered its services to potential and existing buyers providing a high-level service not only during sale but also after-sale care in order to keep our customers, whom we consider our true partners, fully satisfied. The professional accountability that distinguishes us, as well as the professionalism of the team that I lead together with my colleague Mr Jungnitsch, also give us cause for optimism for the second half of this year, notwithstanding the tough economic situation, the least favourable terrain due to constant change, the failure to include the market players in the decision-making process, and the taxes which have a direct impact on the performance of this market.

We have continued to add to the brands that we represent. We have a very conscientious partner with several decades of international experience in our sister company Porsche Leasing. We have a sales and service network with our distributors in the main cities of Albania including Shkodër, Tirana, Fier and Gjirokastër. We are able to tailor our offers, sales offers and after-sale care, and associated financing schemes, to the interests and wishes of our partners. We are able to compete in various tendering processes, offering the best products at the best price. We are part of a company that owns the greatest distribution network in Europe, namely Porsche Holding. Our product portfolio is made of the leading brands of the wellknown Volkswagen Group, and i am proud to say that Porsche Albania has the best qualified and most successful staff in the Albanian automotive market.

These are the values that make us, Porsche Albania, feel confident that our leading position in the Albanian automotive market will be consolidated, not only because we want to be your first choice, but because we believe in the partnership that we’ve built up, in the ability to work together to meet all your requirements for quality products, tailored to your needs and brought to you in one single successful package: car + financing + registration + service.

Furthermore, the European path that Albania has embarked upon makes us optimistic not only that new legislation will be more favourable to new cars, but also that the benefits for citizens will be considerably greater.

I wish you all happy summer holidays!




# E ardhmja ka mbërritur
## The future is here

**Makina hibride XL1 harxhon më pak se 1 litër. Kryevepra teknike e prodhuar prej karboni dhe alumini konsumon vetëm 0,9 litra karburant për më shumë se 100 km.**

The hybrid XL1 undercuts the 1-litre mark. The technical masterpiece made of carbon and aluminium consumes just 0.9 litres of fuel over 100 km.

VW XL1 – të dhënat kryesore:
›Koncepti: hibrid i karikueshëm me korrent
›Motori me djegie të brendshme: R2 TDI 0,8 litra
›Fuqia: 35 kW
›Fuqia e elektromotorit: 20 kW
›Bateritë: Me jone litiumi
›Kapaciteti: 5,5 kWh
›Distanca që mund të përshkohet me energji elektrike: 50 km
›0-100 km/orë: 12,7 sekonda
›Konsumi mesatar (i kombinuar): 0,9 litra
›Shpejtësia maksimale: 160 km/orë (e kufizuar)
›Transmisioni: DSG me 7 marshe
›Serbatori i karburantit: 10 litra
›Hapësira e bagazhit: 120 litra
›Pesha: 795 kg
›Koeficienti i rezistencës aerodinamike (vlera Cw): 0.189

Motori me djegie të brendshme dhe elektromotori i XL1 janë të montuar mbi aksin e pasmë dhe bateritë në aksin e përparmë.

Volkswagen ka vendosur se një makine nuk i duhet më shumë se 1 litër karburant dhe ka prodhuar një numër të vogël të kësaj risie për ta vërtetuar këtë. Kjo është një kryevepër e konstruksionit me peshë të lehtë, aerodinamikës dhe efikasitetit në karburant - VW XL1.

Punëtorët e Volkswagen-it punojnë me saktësinë dhe precizionin e lartë të orëndreqësve në pjesët e karbonit. Ata i mbërthejnë pjesët e karbonit në një skelet alumini, vendosin ngjitës në buzët e tyre dhe mbyllin njësinë e presimit. “Për shkak të hapësirave të vogla të XL1, nuk ka vend për gabime dhe na duhet të punojmë me saktësinë deri në të dhjetën e milimetrit”, - shpjegon një nga teknikët në

fabrikën e Volkswagen në Osnabrück, Gjermani. Kjo është fabrika ku po prodhohet, kryesisht me dorë, një numër i vogël i prototipit të ri XL1. Në fazën e parë do të prodhohet një total prej 250 makinash. “Ferdinand Piëch pati në fillim idenë për të ndërtuar një makinë që harxhon 1 litër”, - thotë dr. Ulrich Hackenberg, VW, anëtar i Bordit Drejtues të VW, përgjegjës për “Zhvillimin”. Në vitin 2002, Prof. Dr. Ferdinand Piëch u nis nga Wolfsburgu për të marrë pjesë në asamblenë e përgjithshme

Volkswagen has decided that a car doesn’t need more than 1 litre of fuel, and has built a small number of its new innovation to prove it. It is a masterpiece of lightweight construction, aerodynamics and fuel-efficiency – the VW XL1.

Volkswagen employees work with the meticulousness and precision of a watchmaker on the carbon parts. They clamp them in an aluminium frame, apply adhesive to the edges and close the press unit. “Due to the tiny clearances with the XL1, we have practically no room for error and have to work to an accuracy of a tenth of a millimetre,” explains one of the technicians in

the Volkswagen factory in Osnabrück, Germany. This is where the small run of the brand-new XL1 prototype is being produced, mostly by hand. A total of only 250 cars are to be built in this first run. “Ferdinand Piëch originally had the idea to build a 1-litre car,” says Dr. Ulrich Hackenberg, VW Board of Management member responsible for ‘Development’. In 2002, Prof. Dr. Ferdinand Piëch travelled from Wolfsburg to the annual general meeting in Hamburg with the 1L concept

vjetore në Hamburg, me studimin e konceptit të tij për makinën "1 litër". "Martin Winterkorn e ngriti edhe një herë këtë ide në vitin 2009", - thotë Hackenberg. Nën udhëheqjen e Prof. Dr. Martin Winterkorn, u prodhua një prototip që i afrohej prodhimit seri të quajtur "L1". Dy sediljet e makinës ishin vënë në konfigurim njëra pas tjetrës dhe lëvizja e makinës sigurohej nga një grup hibrid i transmetimit të fuqisë. L1 kishte një fuqi efektive 39 bhp dhe mund të arrinte një shpejtësi maksimale prej 160 km/orë – por e tejkalonte me 380 mililitra konsumin e synuar prej 1 litri. XL1 u shfaq para publikut që e priste në Auto Sallonin e 83-të në Gjenevë, i zhvilluar në datat 7-17 mars 2013. Automjeti hibrid ishte në një masë të konsiderueshme poshtë kufirit magjik prej 1 litri. Kryevepra teknike e përbërë nga karboni dhe alumini konsumon vetëm 0,9 litra karburant për mbi 100 km. Kjo nuk ndodh vetëm për shkak të sistemit novator të transmisionit, por gjithashtu edhe në sajë të aerodinamikës së sofistikuar dhe konstruksionit me peshë të lehtë.

study. "Martin Winterkorn picked up the idea again in 2009," says Hackenberg. Under the stewardship of Prof. Dr. Martin Winterkorn, a prototype that was close to serial production called the L1 was built. The car's two seats were arranged one behind the other and drive was provided by a hybrid drivetrain. The L1 came in at 39 bhp and could reach a top speed of 160 kph – but exceeded the target consumption of one litre by 380 millilitres. The XL1 was unveiled to the waiting public at the 83rd Auto Salon in Geneva, held between 7 and 17 March 2013. The hybrid vehicle falls below the magical 1-litre mark by a significant margin. The technical masterpiece made of carbon and aluminium consumes just 0.9 litres of fuel over 100 km. This isn't simply due to the innovative drive system, it's also down to the sophisticated aerodynamics and lightweight construction.

VW Xl1 – the key facts:
›Concept: plug-in hybrid
›Combustion engine: 0.8-litre R2 TDI
›Power: 35 kW
›Electric motor power: 20 kW
›Batteries: Lithium-ion
›Capacity: 5.5 kWh
›Range on electric power: 50 km
›0–100 kph: 12.7 seconds
›Average consumption (combined): 0.9 l
›Top speed: 160 kph (restricted)
›Transmission: 7-speed DSG
›Fuel tank: 10 l
›Boot space: 120 l
›Weight: 795 kg
›Drag coefficient (cw value): 0.189

The XL1's engine and electric motor are mounted above the rear axle and the batteries at the front axle.

# Volkswagen feston prodhimin e Golf-it të 30 milion-të

Golf-i i 30 miliontë në botë del nga linja e montimit në Wolfsburg

# Volkswagen celebrates the 30 millionth Golf

World's 30 millionth Golf drives off the assembly line in Wolfsburg



## Jepet në Wolfburg çmimi "Makina e vitit 2013"

Wolfsburg, 14 qershor 2013 – Kjo është një ngjarje me përmasa historike: Golf-i i 30 miliontë në botë ka dalë nga linja e montimit në fabrikën e Volkswagen-it në Wolfsburg – një rekord i ri në prodhimin e makinës më të suksesshme ndonjëherë në Evropë. Prodhimi i makinës së parë Golf ka nisur në fillim të vitit 1974. Që nga ajo kohë, e shprehur me shifra, mesatarisht mbi 2000 vetë kanë blerë çdo ditë një Golf të ri – vetë "das Auto" – gjatë 39 viteve të kaluara. Makina e 30 miliontë është një Golf TDI BlueMotion; ky model i prezantuar së fundmi ka një vlerë të konsumit të karburantit prej vetëm 3,2 litra/100 km, duke e bërë atë modelin Golf më ekonomik që është prodhuar ndonjëherë.

## "Car of the Year 2013" award presented in Wolfsburg

Wolfsburg, 14 June 2013 - It is an event of historical dimensions: the world's 30 millionth Golf has come off the assembly line at the Volkswagen plant in Wolfsburg – a new production record for the most successful European car ever. Production of the original Golf began in early 1974. Since then, statistically speaking, an average of over 2,000 people have purchased a new Golf – "das Auto" itself – every day over the past 39 years. The 30 millionth car is a Golf TDI BlueMotion; this recently introduced model has a fuel consumption value of just 3.2 l/100 km, making it the most fuel efficient Golf ever built.

# Porsche Albania i uron mirëseardhjen në grup kompanive të reja Porsche Leasing / Porsche Mobility!

## Porsche Albania welcomes Porsche Leasing / Porsche Mobility to the Team!



**Fabian Jungnitsch**
Drejtorin e Përgjithshëm të Porsche Albania / General Manager at Porsche Albania

Fillimi i vitit 2013 shënoi nisjen e punës për përgatitjet për aktivitetet e financimit të makinave të sektorit bankar të Porsche Holding në Shqipëri. Një pjesë e sallonit tonë për makinat Skoda u mbulua për të rritur hapësirën e zyrave me 50 m2. Gjysma e hapësirës u përdor për të krijuar një zyrë moderne për Porsche Leasing/Mobility dhe gjysma tjetër u kthye në një sallë të madhe për mbledhje.

Meqenëse ndërtimi kishte përfunduar në fillim të muajit mars, ishte koha e përshtatshme për të përgatitur punën operative, kështu që punonjësit e parë të Porsche Leasing/Mobility filluan punën në muajin janar 2013, të ndjekur nga grupi i dytë i punonjësve që filluan punë në muajin qershor. Që nga ai moment Porsche Mobility Ltd u regjistrua si biznes i rregullt dhe në portofolin e saj u shtuan kontratat e para të leasing-ut. Porsche Leasing Ltd do të jetë plotësisht funksionale gjatë sezonit të verës 2013, për të ofruar produktet e saj të dhënies me qira të makinave familjare.

Jemi të bindur që përvoja dhe ekspertiza që Porsche Leasing/Mobility sjell në tregun e produkteve të financimit të makinave, e ndërthurur me shërbimet dhe produktet tona cilësore shumë të vlerësuara, do t'u ofrojnë klientëve tanë një paketë të plotë shërbimesh - praktikisht një "one-stop shop", - e cila është e para e këtij lloji në tregun e makinave në Shqipëri.

Ne jemi të vendosur të ecim përpara për t'u ofruar klientëve tanë edhe më shumë shërbime dhe produkte të përshtatura saktësisht sipas nevojave të tyre, gjë e cila çon në rritjen e kënaqësisë së klientit dhe të besnikërisë së tij ndaj nesh, një model që ka rezultuar i suksesshëm në shumë tregje të tjera të Evropës Juglindore, ku bashkëpunimi midis departamentit të shitjeve të Porsche dhe institucioneve financiare është vendosur prej shumë vitesh.

I urojmë ekipit të Porsche Mobility/Leasing një fillim të suksesshëm në tregun Shqiptar dhe jemi të bindur në bashkëpunimin e frytshëm me Porsche Albanian. Të gjithë lexuesve tanë i urojmë pushime të mbara verore dhe sukses në gjysmën e dytë të vitit.

The start of 2013 saw work begin on preparations for the car financing activities of the Porsche Holding Bank Sector in Albania. Part of our Skoda showroom was covered to extend the Office space by 50m2. Half of the space was used to create a modern office for Porsche Leasing/Mobility, and the other half was transformed into a spacious meeting room.

As construction was finished by early January it was time to prepare the operational launch, so the first employee of Porsche Leasing/ Mobility started work in March 2013 followed by a second one in June. As of that moment Porsche Mobility Ltd was legally established and the first operative leasing contracts had already been added to the portfolio. Porsche Leasing Ltd will be fully operational in the summer of 2013, offering its familiar car rental products.

We believe that the experience and expertise that Porsche Leasing/ Mobility brings to the field of car finance products, combined with our highly regarded quality products and services, will provide our customers with a complete package – effectively a one-stop shop - which is a first for the Albanian automotive market.

Together we are determined, moving forward, to offer our customers even more bespoke products and services for their exact needs, resulting in increased customer satisfaction and loyalty, a model that has been a proven success in many other CEE markets in which cooperation between the Porsche sales and finance organisations has been in place for many years.

We wish the team of Porsche Mobility/Leasing a great start in the Albanian market and are certain about the fruitful cooperation with Porsche Albania. To our readers relaxing summer vacations and a succesful second half of the year!

# Tashmë në Shqipëri
## Now in Albania

### Porsche Bank – Një kompani me histori.

Porsche Bank AG, si një degë e Porsche Holding e ndodhur në Salcburg, është një kompani ndërkombëtare, që ofron shërbime për financimin e makinave.

Që nga themelimi i saj në vitin 1966 Porsche Bank ka qenë në gjendje të zgjerojë pozicionin e saj në treg në Austri në sajë të bashkëpunimit efikas me organizata shpërndarjeje të markave të grupit Volkswagen dhe Porsche si edhe të pozicionit të fortë në treg të makinave të tyre.

Që nga viti 1994, Porsche Bank AG ka hapur degë në disa vende në të cilat Austrian Porsche Holding është aktiv si importues ose në tregtinë e shitjes me pakicë: Hungari, Slloveni, Sllovaki, Kroaci, Rumani, Serbi/ Mali i Zi, Bullgari dhe Ukrainë. Porsche Bank tashmë është pioniere në këto vende, sikurse ishte edhe në Austri më tepër se 40 vjet më parë, duke ofruar shërbime të reja në tregjet e tyre.

Porsche, ka shprehur qëllimin e saj për të ofruar të gjitha shërbimet që lidhen me makinat nga një burim i vetëm, për të gjitha markat VW, Audi, Seat, Skoda, Porsche, Bentley, Lamborghini, Bugatti dhe Weltauto: oferta financimi, siguracione, mirëmbajtje dhe menaxhim profesional i flotave të automjeteve – të leverdishme dhe të përshtatura për nevojat individuale të klientëve.

Këto e bëjnë pronësinë, financimin dhe drejtimin e një automjeti sa më të rehatshëm dhe ekonomik që është e mundur.

### Porsche Finance Group Albania

Porsche Finance Group Albania përbëhet nga dy kompani: Porsche Leasing dhe Porsche Mobility. Detyra kryesore e këtyre dy kompanive është, që t'u ofrojnë klientëve të tyre, zgjidhjet optimale për blerjen e makinave nëpërmjet leasing-ut financiar (qirasë financiare), ose dhënies me qira të automjeteve VW, Audi, Seat, Škoda, Porsche dhe Welauto në tregun lokal.

Ndryshimi kryesor ndërmjet Porsche Leasing dhe Porsche Mobility, është se specialiteti i Porsche Leasing është ofrimi i leasing-ut financiar për klientët, ndërsa Porsche Mobility ofron dhënien me qira të makinave, qe përfshin konceptin e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të flotave të automjeteve, për kompanitë që dëshirojnë t'ia besojnë profesionistëve drejtimin e flotave të tyre të automjeteve.

### Ndryshimi ndërmjet leasing dhe dhënies së makinave me qira:

Ndryshimi kryesor ndërmjet leasing-ut financiar dhe dhënies me qira të makinave është se e para përfshin financimin për blerje (qiramarrësi bëhet pronar i objektit të leasing-ut pasi paguan këstin e fundit të qirasë financiare), ndërsa e dyta përfshin përdorimin e objektit të leasing-ut. Në dhënien me qira, automjeti i jepet qiramarrësit për përdorim, gjë që është shumë e ngjashme me konceptin e njohur të marrjes me qira të makinës. Në fund të periudhës së qirasë, nuk ndodh asnjë ndryshim në pronësi dhe automjeti i kthehet qiradhënësit, gjë që është më e përshtatshme për kompanitë që dëshirojnë të ndryshojnë automjetet në flotën e tyre.

### Porsche Bank - A company with a history.

As a subsidiary of Porsche Holding located in Salzburg, Porsche bank AG is an international company offering car financing services.

Since the foundation in 1966 Porsche Bank has been able to extend its market position in Austria due to effective cooperation with the distribution organisations of the Volkswagen group brands and Porsche and the strong market position of their cars.

Since 1994 Porsche Bank AG has established subsidiaries in several countries in which the Austrian Porsche Holding is active as importer or in retail trade: Hungary, Slovenia, Slovakia, Croatia, Romania, Serbia / Montenegro, Bulgaria and Ukraine. Just as it was in Austria more than 40 years ago, Porsche Bank is now a pioneer in these countries, offering new services to their markets.

It is Porsche's declared aim to offer all car related services from a single source for VW, Audi, Seat, Skoda, Porsche, Bentley, Lamborghini, Bugatti and Weltauto: financing offers, insurances, maintenance and professional fleet management - convenient and tailored to the individual needs of the customers.

This makes owning, financing and driving as comfortable and economic as possible.

### Porsche Finance Group Albania

Porsche Finance group Albania consists of two companies: Porsche Leasing and Porsche Mobility. The main task of these two companies is to provide their clients with the most optimal solutions for car purchase by way of financial leasing or rental of VW, Audi, Seat, Škoda, Porsche and Welauto vehicles on the local market.

The main difference between Porsche Leasing and Porsche Mobility is that Porsche Leasing specialises in providing customers with financial leasing, while Porsche Mobility provides car rental, maintenance and Fleet management concept to the companies that wish to entrust running their own fleet to professionals.

### The difference between leasing and car rental:

The main difference between financial leasing and car rental is that the former includes financing of the purchase (the lessee becomes the owner of the subject of leasing upon the repayment of the final leasing installment), whereas the latter involves the use of the subject of the leasing. In car rental, the vehicle is given to the renter to use, which is very similar to the popular rent-a-car concept. At the end of the rental period, no changes in ownership occur and the vehicle is returned to the lessor, which best suits the companies changing their fleet.

## Avantazhet e leasing:

- Kushte të favorshme financimi
- Objekti i leasing-ut financon veten – shpenzimet paguhen nga të ardhurat e gjeneruara nga përdorimi i objektit
- Përshtatja e detyrimit financiar mujor me burimet dhe nevojat e klientit
- Miratim i shpejtë – një procedurë e thjeshtë dhe efikase

## Avantazhet e dhënies së makinave me qira:

- Dhënia e makinave me qira është forma e përdorimit të objektit të përzgjedhur nga qiramarrësi
- Objekti i qirasë mbahet në regjistrat e Porsche Mobility
- Qiradhënia nuk raportohet në Rregjistrin e Kredive, si ngarkesë krediti e klientit
- Qiradhënia zbritet për bazën e tatimit mbi të ardhurat, sepse këstet njihen si shpenzime të tatueshme
- Në fillim të marrëveshjes, qiramarrësi paguan depozitën
- TVSH-ja paguhet nëpërmjet kësteve mujore

## Koncepti i menaxhimit të flotës së automjeteve:

Menaxhimi i flotës së automjeteve është një detyrë komplekse.

Është më e lehtë dhe më ekonomike për subjektet juridike që kanë një numër të madh automjetesh në flotën e tyre që t’ia besojnë profesionistëve këtë flotë automjetesh.

Koncepti i menaxhimit të flotës realizohet nëpërmjet lidhjes së një kontrate mirëmbajtjeje. Kontrata e mirëmbajtjes mund të bazohet në kosto fikse, të akumuluara ose të ndryshueshme dhe përfshin si më poshtë:

- servisin e riparimit të këshilluar nga prodhuesi dhe të gjitha llojet e riparimeve (përveç rasteve të garancive të rimbursuara nga fabrika dhe ngjarjeve jo të favorshme – aksidentet, dëmtimet për shkak të katastrofave natyrore, ngjarjet natyrore të paparashikuara dhe jashtë kontrollit të njeriut etj., të mbuluara nga sigurimi KASKO)

- periudhën e mirëmbajtjes dhe kilometrazhin vjetor sipas nevojave të klientit
- servisin e mirëmbajtjes dhe riparimit sipas rregullores së prodhuesit të automjetit
- riparimin e automjeteve për shkak të shfrytëzimit dhe zëvendësimin e pjesëve rezervë
- zëvendësimin e vajit dhe lubrifikantëve siç këshillohet nga prodhuesi i automjetit
- zëvendësimin dhe ruajtjen pa pagesë te gomave verore dhe dimërore (sipas kërkesës)
- një llogaritje të detajuar të kostove të riparimit

Koncepti i menaxhimit të flotës së automjeteve sjell përfitime të shumta për përdoruesit e tij dhe disa prej tyre janë: mirëmbajtja optimale e automjeteve – nga pikëpamja ekonomike dhe teknike, planifikimi i thjeshtë i kostove, kosto më të ulëta të mirëmbajtjes dhe riparimeve, kursimi i kostove administrative, motivimi i punonjësve për të përdorur automjetet e kompanisë, kontrolli i detajuar i faturave të servisit, kontrolli i detajuar dhe raportet e sakta për klientin.

Jemi këtu për t’i dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve tuaja dhe për t’ju ofruar zgjidhjet më të mira për blerjen e një automjeti nëpërmjet leasing-ut financiar ose dhënies me qira.

*Ne financojmë ëndrrën tuaj.*
Kontakt: info@porscheleasing.al / Tel: ++355 (04) 450 08 28

## Advantages of leasing:

- Favourable financing conditions
- The subject of the lease finances itself – the expenses are paid from the revenue generated from the use of the subject
- Tailoring of the monthly financial obligation to the customer’s resources and needs
- Fast approval – a simple and efficient procedure

## Advantages of car rental:

- Car rental is the form of using the selected subject by the renter
- The subject of the rental is kept in the books of Porsche Mobility
- The rental is not repoted to the Credit Agency as the client’s credit load
- The rental is reduced for the income tax base, since installments are recognized as tax expenses
- At the start of the arrangement, the renter pays the deposit
- VAT is paid through the monthly installment

## Fleet management concept:

Fleet management represents a complex task.

Legal entities that have a great number of vehicles in their fleet find it easier and more economical to entrust their fleet to the professionals.

Fleet management concept is realized through the conclusion of the maintenance contract. The maintenance contract may be based on fixed, accrual or variable costs and includes the following:

repair services prescribed by the manufacturer and all kinds of repairs (except in cases of guarantees refunded by the factory and adverse events - accidents, damages due to natural disasters, acts of God, etc. covered by KASKO insurance)

- the period of maintenance and annual mileage according to the customer’s needs
- maintenance and repair services according to the regulation of the vehicle manufacturer
- repairs of vehicles due to exploitation and replacement of spare parts
- replacement of oils and lubricants prescribed by the vehicle manufacturer
- replacement and storage of winter and summer tires (on request) non-cash payment
- a detailed calculation of repair costs

Fleet Management concept brings many benefits to its users and some of them are: optimal maintenance of vehicles - from an economic and technical point of view, simple and easy costs planning, lower maintenance and repairs costs, saving on administrative costs, employee motivation for the use of company vehicles, detailed control of service invoices, detailed control and precise reports to the customer.

We are here to answer all your questions and to provide you with the best solutions for the purchase of vehicles through financial leasing or renting.

*We finance your dream.*
Contact: info@porscheleasing.al / Tel: ++355 (04) 450 08 28


Së bashku ne mund të bëjmë më shumë.
Porsche Leasing dhe Porsche Albania zgjidhje e përkryer për makinën tuaj të ëndrrave.
PORSCHE LEASING

# Audi A3 Sedan



## Hyrja në një segment të ri të tregut

## Launch into a new market segment

*Me prezantimin e A3 Sedan këtë pranverë, Audi po hyn në segmentin e tregut më të madh në botë, në kategorinë sedanëve kompakt. Kjo makinë dinamike me katër dyer përfshin të gjitha pika e forta të serisë A3 – peshën e ulët falë konstruksionit me peshë të lehtë, motorët e fuqishëm dhe shumë efikasë, një mori zgjidhjesh të nivelit të lartë për informimin dhe zbavitjen, si dhe sistemet ndihmëse për shoferin. Modeli më i mirë i serisë është S3 Sedan me 221 kW (300 hp).*

### Dizajni i jashtëm

*Audi A3 Sedan ka një qëndrim sportiv në rrugë, është i saktë dhe tejet ekspresiv në çdo detaj. Dizajni i tij është një kombinim midis konceptit klasik me tre ndarje dhe filozofisë coupé. Elementi i dizajnit "vija e uraganit" formon një linjë të dallueshme dritëpërthyese që vazhdon përgjatë të gjithë krahut. Pjesët e dala janë të shkurtra. Kjo makinë me katër dyer ka një distancë midis aksesh 2,64 metra të gjatë dhe një gjatësi të përgjithshme prej 4,46 metrash.*

*Mbi bordurat anësore, linja dinamike ngrihet më e pjerrët se në dy modelet e tjera A3. Sipërfaqet anësore janë shumë më të harkuara dhe harqet e rrotave janë paksa më të zgjeruara.*

*Kjo makinë me katër dyer i shfaq linjat e pavarura edhe në konturin e kofanos, në parakolpe, te futja e ajrit dhe në përdorimin e grilës me një trup.*

*With the launch of the A3 Sedan this spring, Audi is entering the world's largest market segment, the class of compact sedans. The dynamic four-door car offers all of the strengths of the A3 model series – with low weight thanks to lightweight design, powerful and highly efficient engines and numerous high-end solutions for infotainment as well as driver assistance systems. The top model of the series is the S3 Sedan with 221 kW (300 hp).*

### Exterior design

*The Audi A3 Sedan has a sporty stance on the road, and it is precise and highly expressive in every detail. Its design is a cross between the classic three-box concept and the coupé philosophy. The "tornado line" design element forms a distinct light-refracting edge that runs over the entire side. The overhangs are short. The four-door car has a 2.64 meter long wheelbase and an overall length of 4.46 meters*

*Above the side sills, the dynamic line rises more sharply than on the other two A3 models. The side surfaces are more intensively curved, and the wheel arches are slightly more flared.*

*The four-door car also expresses independent lines in the contour of its hood, in the bumpers, air intakes and its implementation of the singleframe grille.*

*Prapa, krahu i pasmë aerodinamik është integruar në derën e bagazhit dhe dritat theksojnë linjat horizontale të makinës me prerjet e gjera e të ulëta. Teknologjia e dritave LED disponohet si opsion. Audi do të ofrojë gjithashtu fenerë tërësisht LED menjëherë pas hedhjes në treg – teknologjia e tyre novatore dhe pamja e veçantë theksojnë pozicionin e jashtëzakonshëm të modelit A3 Sedan.*

## Hapësira e brendshme

*Hapësira e brendshme e Audi A3 karakterizohet nga vëmendja mbresëlënëse ndaj detajeve. Linjat dhe sipërfaqet janë dizajnuar me saktësi, ndërsa një hark i madh shtrihet në të gjithë gjerësinë e xhamit të përparmë. Paneli i instrumenteve me faqen ballore të lakuar është i hollë, dhe konsola qendrore është e kthyer paksa nga drejtuesi. Ekrani opsional me ngjyra i sistemit të informimit të drejtuesit (DIS) afishon imazhe me grafikë 3D tejet të detajuar.*

*Duke filluar me sistemin e radios MMI, sistemi operativ MMI ka një ekran që zgjerohet në mënyrë elektrike. Terminali i tij gjendet brenda në konsolën e folesë qendrore. Freni elektromekanik i parkimit aktivizohet me shtypjen e një butoni. Timoni ka tre ose katër ndarje, në varësi nga versioni. Klienti mund të porosisë edhe timon me fund të sheshtë, me taste multifunksionale dhe me taste të ndryshimit të marsheve. Audi ofron si opsion vendosjen e sediljeve të përparme sportive. Ato janë pjesë standarde e linjës Ambition, ku ofrohen si opsion sediljet sportive S me mbështetëse koke të integruar.*

## Veçoritë

*Audi A3 Sedan i ri po hyn në treg me një sërë veçorish standarde. Paketa e sistemeve të kufizimit përfshin një jastëk ajri te gjunjët e shoferit. Ekrani me ngjyra i DIS-së në versionet Ambition dhe Ambiente përfshin një program efikasiteti, tregues të marsheve dhe një veçori për të këshilluar një pushim.*

*Përveç kësaj, versioni Ambition ka zbutje sportive, rrota aliazhi 17”, sedilje sportive dhe sistemin e Audi-t për zgjedhjen e mënyrës së ngarjes. Versioni Ambiente përfshin edhe një sistem të kontrollit të drejtimit, paketë të ndriçimit të brendshëm me LED dhe ndihmës parkimi prapa. Përveç këtyre veçorive standarde, Audi ofron opsione të tjera të komfortit individual dhe komoditetit, si p.sh. tavani me hapje me xham panoramik, çelësi praktik, ngrohja shtesë dhe dritat përshtatëse me bazë ksenoni. Së bashku me MMI Navigation plus, sistemi i ndriçimit përdor të dhënat e rrugës për të ndriçuar në mënyrë optimale rrugën përpara sipas kushteve të drejtimit.*

*Falë veçorive dhe dizajnit të tij unik, ky model premton të japë një performancë elegante dhe mbresëlënëse. Fillimi i tetorit do të jetë koha më e afërt kur publiku shqiptar mund të prenotojë një xhiro prove me këtë model.*

*At the rear, the spoiler is integrated in the trunk lid, and the lights emphasize the car’s horizontal lines with their broad and low cuts. LED technology is available as an option. Audi will also be offering full-LED headlights right at market launch – their innovative technology and distinctive appearance underscore the exceptional positioning of the A3 Sedan.*

## Interior

*The interior of the Audi A3 Sedan is characterized by impressive attention to detail. The lines and surfaces are cleanly designed, and a long arc spans the width of the windshield. The instrument panel with its curved front is slender, and the center console is slightly turned towards the driver. The optional color display of the driver information system (DIS) shows images in highly detailed 3D graphics.*

*Starting with the MMI Radio system, the MMI operating system has an electrically extending screen. Its terminal is housed in the console of the center tunnel. The electromechanical parking brake is activated by a pushbutton. The steering wheel has either three or four spokes, depending on the version. The customer can also order the steering wheel with a flat bottom, multifunction keys and shift paddles. Audi can also install sport seats in the front as an option. They are standard in the Ambition line, where S sport seats with integrated head restraints are available as an option.*

## Features

*The new Audi A3 Sedan is launching with a generous set of standard features. The package of restraint systems includes a knee airbag for the driver. The DIS with color display in the Ambition and Ambiente lines includes an efficiency program, gearshift indicator and rest recommendation feature.*

*In addition, the Ambition line has a sport suspension, 17-inch-alloy wheels, sport seats and the Audi drive select system. The Ambiente line adds a cruise control system, interior LED lighting package and rear parking assistant. In addition to these standard features, Audi also offers other individual comfort and convenience options – such as a panoramic glass sunroof, convenience key, auxiliary heating and xenon-based adaptive lights. In conjunction with MMI Navigation plus, the lighting system utilizes route data to optimally illuminate the roadway depending on the driving situation.*

*Thanks to its unique design and features this model promises to deliver a stylish and impressive performance. Early October would be the earliest date when the Albanian public can schedule a personalized test drive with this model.*







ALBARENT
RENT A CAR ALBANIA
Zgjidhje me mend!
VIP – LOUNGE
MAKINA ME QIRA
ALBARENT tours
0682042211 - 0686046901
www.albarent.al

SIMPLY CLEVER

ŠKODA

# Summer Tatoo Personalizo Citigon tënde!



Konsumi dhe emetimet e kombinuara të $CO_2$ per modelin Citigo: 4.5 l/100 km, 105 g/km

Të gjithë njerëzit janë të ndryshëm dhe ne në Porsche Albania nuk shohim asnjë arsye përse makina duhet të jetë e njëjtë. Për këtë arsye këtë verë keni mundësinë që jo vetëm të përfitoni nga financimi 100% për të bërë tuajën ŠKODA Citigo por edhe ta personalizoni atë me një nga modelet e parapërgatitura për ju apo me një dizajn tuajin. Na vizitoni sot dhe përfitoni makinën tuaj

www.skoda-auto.al

Për më tepër na vizitoni në tre sallonet tona:

PORSCHE
ALBANIA
Autostrada Tiranë-Durrës km. 3, Tiranë,
Cel: +355 (0) 69 20 57 740,
E.: info@skoda-auto.al, www.skoda-auto.al.

E.T.T Group Auto Sh.p.k
Kthesa e Viroit, Gjirokastër
Cel.: +355 (0) 69 40 52 594
E.: ettgroupauto@gmail.com

KOSTANDIN
GROUP
Rruga Nacionale Shkodër-Tiranë
Cel.: +355 (0) 69 40 89 491
E.: info@kostandingroup.com

Lidhu!

**Ke vetem 1 jete.**

powered by: PORSCHE ALBANIA

Sipas institutit të shëndetit publik, gjatë 5 viteve të fundit kanë humbur jetën 1742 persona dhe 5108 të tjerë janë plagosur rëndë gjatë aksidenteve rrugore.

According to the Institute of Public Health, 1,742 people lost their lives in the last 5 years and 5,108 others have been seriously injured in road accidents.




# Lidhu! Ke vetëm një jetë

## Click it! You only have one life.

Ky ishte slogani i projektit mbi sigurinë rrugore mbështetur nga Porsche Albania.

Numri i madh i aksidenteve në rrugët e Shqipërisë ka sjellë pasoja të rënda për shoqërinë shqiptare ku me të drejtë flitet për një bilanc lufte. Aksidenti rrugor është një plagë për individin dhe familjen e tij, por efektet e tij prekin të gjithë shoqërinë. Gjatë një aksidenti rrugor dëmtohet apo humb jetën ajo pjesë e shoqërisë, e cila është edhe më aktive. Një person i cili i ka kushtuar shumë familjes dhe shoqërisë për rritjen, edukimin dhe kujdesin mjekësor, humb jetën apo dëmtohen të fazën më produktive të jetës.

Kjo ishte edhe shtysa që e nxiti kompaninë Porsche Albania të mbështeste projektin “Lidhu! Ke vetëm një jetë”. Në kuadër të këtij projekti u zhvillua një zinxhir prezantimesh në universitete publike dhe private, ku studentëve u paraqitën shkurtimisht statistika mbi efektet e mosvendosjes së rripit, u diskutuan mite dhe pretekste për mosvendosjen e rripit të sigurimit, si dhe u shfaqën disa video mbi dinamikat e aksidenteve në rrugë.

“Ne arritëm t’ua përcillnim mesazhin tonë mbi 1000 studentëve në tetë fakultete të ndryshme publike dhe private, por shumë të tjerë u sensibilizuan nëpërmjet spoteve radiofonike apo rrjeteve sociale për rëndësinë e një veprimi që të merr vetëm 3 sekonda, por që mund të të japë vite të tëra jetë”, – u shpreh drejtori i marketingut në Porsche Albania, z. Dorian Mehmeti.

Ky aktivitet përkon me dekadën mbi sigurinë rrugore të shpallur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

*This was the slogan of the road safety project supported by Porsche Albania.*

*The high number of accidents on Albania’s roads has had serious consequences for Albanian society, where it could rightly be described as matching the death toll in war. Road accidents blight not only the individuals concerned and their families, but also society as a whole. In road accidents, it is the most active members of our society who are injured or killed. People who have cost their families and society a fortune in upbringing, education and health care, lose their lives or are injured at the most productive stage of their lives.*

*This was also what prompted Porsche Albania to support the “Belt Up! You only have one life” project. Under the auspices of this project a series of presentations were held at state and private universities, where students were briefly introduced to the statistics on the consequences of not fastening their seat belts, a number of discussions were held concerning myths and excuses for not fastening seat belts, and several videos were shown depicting the dynamics of road accidents.*

*“We successfully conveyed our message to over 1,000 students at eight different state and private universities, but many others were also made aware, either through messages broadcast on the radio or via social networks, of the importance of a simple action which only takes 3 seconds, but can give you years of life” – stated the Marketing Director of Porsche Albania, Mr Dorian Mehmeti.*

*This activity is part of the Decade of Action for Road Safety declared by the World Health Organisation.*






# Audi A4
# Pulsi i progresit

Audi i ri A4 mbart shumë më tepër nga ç'kishit imagjinuar. Ky model vjen sot me përfitime të barabarta me vlerën e karburantit të konsumuar dhe shërbimeve periodike për 3 vjet. Audi i ri A4, këtë verë për 33,000 Euro.

Pajisjet e përfshira në ofertë: *ABS me EDL, ESC, ASR, * Frena dore elektromekanike, * Airbag për shoferin dhe pasagjerin, * Airbag anësor, * Sistem airbag për kokën "sideguard", * Karroceria e galvanizuar, * Filtër pluhuri dhe poleni, * Timon multifunksional lëkure me 4 krahë, * Paketë e jashtme e kromuar, * Sistem parkimi prapa, * Sensor shiu dhe drite, * Rregullues I largësisë së dritës, *  Xenon Plus dhe Stopa LED, * Radio Concert me 8 bokse, mp3 dhe lexues karte memorie * Larës feneresh, * Klima komfort me 3 zona, * Disqe alumini 10 krahë 16" etj.

Për më tepër informacion: +355 (0) 69 20 57 232

Audi
Vorsprung durch Technik



# Emocion me SEAT Leon.

## *Emotion with SEAT Leon.*

**Intervistë me Suada Yzon, fituese e shorteut "Emocion" nga SEAT Leon.**

Promovimi i SEAT Leon të ri për herë të parë u bë tërësisht online nëpërmjet një konkursi me fotografi ku njerëzit u ftuan të vendosnin foton tyre. Një numër i madh pjesëmarrësish votuan foton e tyre të preferuar, si dhe ngarkuan foton e tyre emocionale, por fituese ishte vetëm një. Suada Yzo arriti të merrte më tepër vota nga vizitorët e faqes së konkursit, por edhe nga miqtë e saj dhe u shpall fituese e konkursit.

Për çmimin e parë, Porsche Albania kishte menduar një fundjavë romantike për dy persona me SEAT Leon-in e ri, një darkë dhe qëndrim në një hotel të veçantë në Vlorë dhe të gjitha këto nën emocionet e një udhëtimi në timonin e SEAT Leon-it të ri.

*I. Si u njohe me konkursin dhe çfarë ju shtyu të merrni pjesë?*

S. Rastësisht pashë në Facebook që Seat ALBANIA organizonte një konkurs me foto emocionuese.

M'u duk ide interesante dhe pa u menduar gjatë zgjodha një foto nga të miat dhe mora pjesë në këtë konkurs.

*I. Fotoja juaj u përzgjodh si foto fituese e konkursit. Sa e vështirë ishte kjo?*

S. Fotoja që përzgjodha më zgjonte kujtime nga pushimet e shkuara dhe mendova thjesht për emocionet që më zgjonte mua. Megjithatë, fotoja ime mori një numër të madh pëlqimesh, si nga vizitorët, ashtu edhe nga miqtë e mi që ftova të votonin për mua në këtë konkurs. Nuk shpresoja të fitoja, sepse gara ishte e fortë, fotot ishin interesante, të gjithë e dëshironin atë udhëtim çift me SEAT Leon në Vlorë që ishte rezervuar për fituesin. Fitova!

*I. Për të gjithë ata të cilët morën pjesë por nuk arritën, si ishte fundjava me SEAT Leon?*

S. Ditën e premte të javës që fotoja ime u shpall si fituese e konkursit, tërhoqa makinën në Porsche Albania dhe u nisëm për një fundjavë ndryshe. Ishte emocionuese. Hipëm në makinë dhe nuk na interesonte më nëse do të shkonim në Vlorë, sepse Seat-i na bëri për vete që në metrat e parë. Shkuam në Vlorë, rrugën e bëmë me shpejt se kurrë më parë. Kaluam një fundjavë të paharrueshme.

*Të gjithë këtë eksperiencë mund ta përshkruaj me pak fjalë: SEAT IS THE BEST!*

Makinë shumë komode jo vetëm në qytet, por edhe në rrugë të gjata. Më i lehti në përdorim në trafikun e qytetit. Lehtësi e madhe parkimi nëpërmjet sensorëve dhe shfaqjes në ekran të tyre. Ishte thjesht një mrekulli.

**Interview with Suada Yzo, winner of "Emotion" contest by SEAT Leon.**

For the very first time, the new SEAT Leon was promoted entirely online through a photo contest, where people were invited to post their photos. A large number of participants voted their favorite photo and uploaded their emotional photo but there was only one lucky winner. Suada Yzo managed to receive the highest number of votes by the visitors of the contest webpage and also by her friends, and was announced as the winner of the contest.

For the first prize winner, Porsche Albania had planned a romantic weekend for two with the new SEAT Leon, dinner and accommodation at a special hotel in Vlora – entirely amazed by the emotion of driving the new SEAT Leon.

*I. How did you get find out and what made you participate in this contest?*

S. I accidentally came across the notification in Facebook that Seat ALBANIA was holding a contest of emotional photos. It seemed interesting and without a second thought I chose one of my photos and participated in this contest.

*I. Your photo was selected as the winning photo of the contest. How challenging was that?*

S. The photo I chose recalls me of my last vacation and I only recollected the emotions it triggered. Nevertheless, my photo received many likes by both visitors and friends whom I invited to vote for me. I did not think that I would win as the contest was highly competitive, the photos were interesting and everyone wanted that trip to Vlora, booked for the winning couple by SEAT Leon. And I won!

*I. For all participants who could not win, how was it like to drive SEAT Leon at that weekend?*

S. On the Friday of the same week my photo was announced as contest winner, I got the car from Porsche Albania and headed to a special weekend. It was a sensational experience. We got into the car and we were no longer interested to go to Vlora, as Seat Leon amazed us from the very first meters we drove. We did go to Vlora and we managed to get there earlier than ever. We had a memorable weekend.

*I may describe all this experience in a few words: SEAT IS THE BEST!*

A very comfortable car not only in the city but also for long distance trips. The easiest to use in the city traffic and can be easily parked thanks to its sensors, also displayed on the screen. It was just wonderful.




Na ndiqni edhe në facebook SEAT Albania si edhe SEAT.AL

Konsumi mesatar: 3.8-6.0 l/100 km. Emetimet e kombinuara të $CO_2$: 99-139 g/km.

# Partneritet i vazhdueshëm

## A continuos partnership

*Interviste me z. Blend Gonxhja, president i kompanisë ALBARENT. .*
*Interview with Mr. Blend Gonxhja, President of ALBARENT.*

*Prej sa kohësh bashkëpunoni me Porsche Albania dhe përse keni përzgjedhur këtë kompani si një ndër partnerët kryesorë të biznesit tuaj?*

*Pa i hequr asnjë vlerë meritave të drejtuesve e menaxherëve të Porsche Albania, për ALBARENT-in thelbësore në këtë dëshirë tonën për të punuar kryesisht me Porsche Albania (në një nivel që kalon përmbi 80% të automjeteve tona operative) dhe markat e përfaqësuara e të trajtuara për tregun prej saj, ka qenë fakti se kemi të bëjmë me një kompani bijë të një konsorciumi të shtrirë në shumë shtete dhe me rrënjë të thella për sa i përket shpërndarjes, pjesëve dhe servisit për markat përkatëse. Gjithashtu, element tjetër me rëndësi është cilësia e lartë, e padiskutueshme si prestigj në treg, por edhe në imagjinatën kolektive, e automjeteve që importohen ekskluzivisht sot nga Porsche Albania, si Skoda, Seat, VW dhe Audi e Porsche. Mjaftojnë këto pesë stema sa popullore, aq edhe në një pjesë legjendare, për të shpjeguar se për ALBARENT është nder të jemi partnerë me Porsche Albania, ku mes plot eksperiencash sundojnë ato pozitivet. Prej vitit 2009 e këtej kemi ditur të zhvillojmë së bashku në interes reciprok bizneset përkatëse duke shtuar vlerat respektive. Dhe mes aspekteve me rëndësi të jashtëzakonshme për këtë bashkëpunim të suksesshëm mes nesh (e kur flas për sukses kjo provohet lehtë mes shifrave në rritje të blerjeve të ALBARENT tek Porsche Albania e të xhiros së biznesit që ne bëjmë me produktet e kësaj kompanie), më kuptimploti është sektori i servisit i Porsche Albania. Për mendimin tim, në kushtet e tregut shqiptar sot, është i vetmi servis bashkëkohor dhe i kompletuar profesionalisht dhe me logjistikë. ADN-së së strukturës së këtij servisi që rrjedh nga vizioni dhe skema e kolauduar me vite të tëra në tregun evropian i shtohen edhe burimet njerëzore që Porsche Albania duket se ka ditur t'i përzgjedhë e t'i trajnojë si duhet për një shërbim dinjitoz.*

*Sa të kënaqur keni qenë nga shërbimi i marrë në Porsche Albania?*

*Servisi në Porsche Albania përbën një armë të fortë të kompanisë. Rastet e ndonjë pakënaqësie, flas si firmë e jo si individ, janë aq të pakta ose aq të parëndësishme krahasuar me pozitivitetin e së tërës saqë mund të dëshmoj veç fjalë të mira për servisin në Porsche Albania dhe stafin e saj. Shpesh në komunikimet që kemi si partnerë, me bonsens këshillojmë njëri-tjetrin, e kur më takon të kërkoj, përsëris dëshirën time që mundësisht ky servis të ofronte shërbime edhe në fundjavë ose edhe në ato orare kur zakonisht të gjithë janë mbyllur, si edhe në sezonet verore kur të gjithë pushojnë me turne të kombinuara – pra, si klient dëshiroj një zgjatje të orarit të punës, sepse ndjehemi si në shtëpinë tonë atje dhe gjejmë zgjidhje më shumë se kudo tjetër.*

*Garancia mbi makinën apo edhe mbi pjesët e këmbimit është një element qendror në komunikimin nga Porsche Albania. Sa të kënaqur keni qenë ju nga ky shërbim?*

Pak më lart e theksova se një nga arsyet më të forta që shpjegon partneritetin tonë është fakti i një kompanie me baza evropiane,

*How long have you been cooperating with Porsche Albania and why have you selected this company as one of the primary partners of your business?*

*Not to detract in any way from the merits of the executives and managers of Porsche Albania, the key factor in ALBARENT's desire to work primarily (at a level exceeding 80% of our operational vehicles) with Porsche Albania and the brands it represents and handles for the market was the fact that it is a daughter company of a consortium covering many countries and one that is firmly established when it comes to distribution, parts and servicing for the respective brands. What's more, another key element is the undisputable high quality of the vehicles exclusively imported today by Porsche Albania, such as Skoda, Seat, VW and Audi, and Porsche, which have a cachet not only in the market but also in the collective consciousness. These five flagship brands, popular to the point of being all but legendary, are reason enough to explain why ALBARENT is honoured to be a Partner of Porsche Albania. Of all the many experiences that our partnership has brought us since 2009, the positives prevail, and we have been able to develop our respective businesses together to our mutual benefit, bringing our respective values to the table. And it goes without saying that one of the most important aspects by far of this successful cooperation between us (and for me success is easily demonstrated by ALBARENT's increasing purchase figures at Porsche Albania as well as the business turnover we generate with this company's products) is the Porsche Albania service sector. In my view, considering the current market conditions in Albania, it is the only fully-fledged and contemporary service, both professionally and logistically. The structural DNA of this service, stemming from planning and vision consolidated over many years in the European market, is complemented by the human resources, which Porsche Albania has clearly selected and trained appropriately with the aim of providing a service worthy of the name.*

*How happy have you been with the service received from Porsche Albania?*

*Porsche Albania's service is a strong point of the company. Cases of dissatisfaction of any kind, and I'm saying this on behalf of the company and not as an individual, are so few or insignificant when set against the overall positive ethos that I can only speak in glowing terms of Porsche Albania service and its staff. In our communications as partners, we often offer good-natured advice to each other, and whenever I have any call to do so, I reiterate my preference that this service should possibly be provided at weekends or at times when everyone's normally closed, as well as during the summer-holiday season when everyone's on leave, by combining shifts. In other words, as a customer, I would like to see longer office hours, because we feel at home that way and home is where we find solutions more than anywhere else.*

*Warranty for machinery and spare parts is a central plank of Porsche Albania's communication. How happy have you been with this service?*

As I pointed out previously, one of the most influential reasons behind our partnership is the fact that we are dealing with a company that

ndërkombëtare dhe ndër vite plot shëndet financiar të sprovuar në tregjet reale, por edhe në shumë tregje të vështira të Lindjes. Kjo shpjegon edhe forcën reale që ky servis ekspozon kur vjen fjala për garancinë, për mbulimin, diagnostifikimin e drejtë të rasteve që janë për garanci ose në diskutim për garanci, profesionalizimin kur ky është më i nevojshëm – atëherë kur klienti është në ditët më të vështira, gjatë por edhe në muajt e fundit të garancisë. Madje kanë qenë të shumta rastet kur ALBARENT ka pasur probleme të natyrave të ndryshme (dihet sesa terren i vështirë, ajër i ndotur e karburante problematike karakterizojnë vendin tonë) edhe në muajt pasi automjeti kishte dalë nga garancia, dhe është pikërisht kjo pikë ku unë, ku ne si ALBARENT, kemi ndjerë realisht diferencën mes Porsche Albania dhe gjithë të tjerëve, sepse kemi parë sesi problemi është trajtuar deri në zëvendësimin e plotë të pjesëve me të reja, kemi parë shpejtësinë në ardhjen e agregatëve dhe një mirëkuptim të plotë, jo sepse ne jemi blerës me rëndësi, por sepse tek Porsche Albania i jepet vlerë markave që importohen prej tyre ekskluzivisht jo deri në ditën e shitjes (si rëndom kudo në treg), por kurdoherë që automjeti i blerë tek ata paraqitet me një problem ose nevojë. Është me të vërtetë një privilegj të punosh e të bashkëpunosh me Porsche Albania, sepse kjo kompani e ofron nivelin shumë të lartë të cilësisë për produktet dhe shërbimet që trajton si një të drejtë të klientit për cilësi dhe nuk është një privilegj nëse të trajtojnë mirë. Për ta, është detyrë të mbajnë klientin të kënaqur dhe t'i shërbejnë me maksimumin e mbulimit me garanci. E thënë me pak fjalë të tjera, Porsche Albania është një copë e vogël e Evropës në kilometrin 3; janë 5 mijë metra zonë evropiane – ajo Evropë ku Shqipëria ëndërron prej vitesh të bëhet pjesë integrale. Kush ka të bëjë, rastësisht apo si zgjedhje e tij, me Porsche Albania, jep dhe merr sikur të ishte një qytetar evropian dhe ndjehet sikur të ishte një qytetar i komunitetit evropian.

Z. Gonxhja ju faleminderit për kohën dhe këtë intervistë dhe ju urojmë punë të mbarë. intervistë dhe ju urojmë punë të mbarë.

is firmly rooted in Europe and across the world. Over the years, this company has enjoyed a robust financial record tested not only in actual markets but also in many difficult eastern markets. This explains the very real impact that this service has when it comes to Warranty, coverage, the proper diagnosis of cases to be covered under warranty, and professionalism when it is needed the most – when the customer is at his lowest ebb, during or even in the last few months of his warranty period. There have even been a number of cases where ALBARENT encountered problems of various kinds (the difficult terrain, polluted air and issues with fuel typical of our country are well known) even after the vehicle warranty had expired, and it was in such cases that I, that ALBARENT really experienced the difference between POAL and all the rest. Because we saw the way they handled the problems up to the full replacement of parts with new ones, prompt arrival of aggregates and a complete understanding. And all this is not because we are important buyers but because Porsche Albania values the brands it exclusively imports, not only up until the day of sale (as is standard practice throughout the market) but whenever the vehicle purchased from them has a problem or needs attention. It is indeed a privilege to work and cooperate with Porsche Albania regardless of the fact that the company provides extremely high quality of products and services as the customer's right to quality, and not as a privilege if you're on good terms with them. Keeping the customer happy and providing him with the maximum warranty coverage is a duty to them. To sum up, Porsche Albania is a little piece of Europe at kilometre 3 of Tirane-Durres Highway, 5 thousand square metres of European territory – the very Europe that Albania has been dreaming of joining for years. Anyone who has occasion to deal with Porsche Albania, whether by chance or their own choice, is treated like a European citizen and feels like a citizen of the European Community.

Thank you, Mr. Gonxhja, for you time and the interview, and we wish you all the best.



# Një taksi të lutem

## Taxi please!

Një ŠKODA Rapid e verdhë me shiritat dhe targat e taksisë e cila priste në sallonin e Porsche Albania-s ngjalli shumë çudi. Jo vetëm klientët që rastisën në sallon në atë moment, por edhe punonjësit e Porsche Albania-s e gjetën veten të habitur dhe u interesuan se përse një taksi kish hyrë në sallonin ŠKODA.

Në fakt kjo ishte një taksi e veçantë. Modeli më i ri i ŠKODA-s ishte "veshur" si taksi për një prezantim ekskluziv të tij që u zhvillua ditën e enjte më 13 qershor, me anëtarë të shoqatës së taksistëve "Tirana".

Taksistët pjesëmarrës patën mundësi të shihnin nga afër këtë model, tiparet unike të tij, si hapësira, konsumi dhe teknologjia në brendësi pa harruar edhe elementin më të fortë që ishte çmimi.

A yellow ŠKODA Rapid with taxi stripes and plates, which was waiting in Porsche Albania showroom aroused the curiosity of everyone. Not only the customers who happened to be in the showroom at that moment, but even Porsche Albania employees were astonished and they were asking what a taxi was doing in ŠKODA showroom.

Actually, this was a special taxi. The latest ŠKODA model was wrapped as a taxi for one of its exclusive displays presented on Thursday 13 June, organised with members of "Tirana" taxi association.

The participating taxi-drivers had the opportunity to observe this model closely, inspect its unique features, such as space, consumption and interior technology, not forgetting the strongest element, the price.

# Piloti i ŠKODA-s Kopecký fiton Rally-n e Azoreve

## *ŠKODA driver Kopecký wins Rally Azores*

Jan Kopecky është fituesi i Rally-t të Azoreve, raundi i katërt i Kampionatit Botëror të Rally-t, duke shënuar kështu fitoren e tij të parë në një garë në rrugë me zhavorr.

Piloti i makinës Skoda e mposhti sfiduesin Craig Breen të Peugeot në ditën e fundit të garës, duke fituar 13 sekonda kryesim gjatë ditës.

Kohën më të shpejtë ai e vendosi në fazën finale të ditës duke lënë kështu pas fantazmën e tij që e përndiqte që kur lëshoi nga duart fitoren në evenimentin e vitit 2010 kur kishin ngelur vetëm 5 km nga përfundimi i garës, duke fituar me 32,2 sekonda.

Breen mbeti i kënaqur me vendin e dytë, duke pasur parasysh se kjo ishte gara e tij e parë në Azore, e ndërlikuar më tej edhe nga fakti se gjatë gjithë kohës gara ishte e shoqëruar nga mjegulla dhe moti i lagësht.

Jan Kopecky won the Rally Azores, the fourth round of the European Rally Championship, to score his first ever victory on a gravel event.

The factory Skoda driver suppressed the challenge of Peugeot's Craig Breen on the final day of the rally, having taken a 13s lead into the day.

He set the fastest time on the final stage of the day, to lay to rest the ghost of him throwing away the 2010 event victory with just 5 km remaining, to win by 32.2 seconds.

Breen was content with his runner-up finish, bearing in mind it was his first event in the Azores, complicated by the fact that the rally was marred by foggy and wet weather conditions throughout.






# Flota ŠKODA për llotarinë Kombëtare

## ŠKODA fleet for the national lottery

Një markë e besueshme dhe një kompani me standarde të larta shërbimi janë kombinimi më i mirë që mund të gjeni tek një partner biznesi. Këto ishin disa nga aspektet që Llotaria Kombëtare vlerësoi tek ŠKODA në Porsche Albania duke e zgjedhur këtë si markën kryesore të flotës së saj. Modelet ŠKODA Fabia, Octavia, Yeti dhe Superb ishin ndër modelet kryesore që u përzgjodhën nga kjo kompani.

A reliable brand and a company performing on very high standards are the best match that you can find at a business partner. These were among the characteristics that the National Lottery appreciated at ŠKODA in Porsche Albania thus choosing it as the main brand for their fleet. Models such as ŠKODA Fabia, Octavia, Yeti and Superb were among the main models that were choosen.





# Caddy Cross Special Edition

*Volswagen ka përdorur motivin dhe emrin "Cross" te versioni për pasagjerë i Caddy-t që tanimë i bashkohet modeleve Polo, Golf dhe Touran të së njëjtës seri.*

*Cross Caddy bazohet në Caddy Edition 30 (prezantuar vitin e kaluar) duke i shtuar të gjitha pjesët e zakonshme për një pamje të ndërthurur më të qëndrueshme. Gjithsesi, nuk keni pse të habiteni kur të mësoni se Cross Caddy i kushton më shumë rëndësi stilit se çdo gjë tjetër.*

*Individualizimi i Caddy-t fillon me elementin mbrojtës që rrethon pjesët plastike në pjesët e poshtme të parakolpeve të parmë dhe atyre të pasëm, të harqeve të rrotave dhe të bordurave anësore.*

*Mbrojtëset përpara dhe prapa me ngjyrë argjendi të shasisë dhe shufrat mbrojtëse nga përplasja anësore e plotësojnë pamjen e saj si të një fuoristrade.*

*Brenda, modeli Cross ka sedilje të përparme sportive me dizajn me dy tonalitete ngjyrash, mbështetëse krahu qendrore dhe timon me rregullim në lartësi dhe gjatësi, zbukurime lëkure me tegela gri në levën e marsheve dhe të frenave të dorës, si dhe zbukurime të brendshme që bëjnë kontrast me derën.*

*Volkswagen has applied its "Cross" theme and name to the passenger version of the Caddy that joins now the Polo, Golf and Touran models of the same series.*

*The Cross Caddy is based on the Caddy Edition 30 (introduced last year) adding the usual bits and pieces for a more robust crossover look. That said, you won't be surprised to learn that the Cross Caddy is more of an exercise in style over substance than anything else.*

*The individualization of Caddy starts with a protective armor that encompasses plastic moldings for the lower parts of the front and rear bumpers, the wheel arches and the side sills.*

*The front and rear silver undercarriage guards and the side impact protection bars on the sills, complete the off-road look.*

*Inside, the Cross model sports front seats in two-tone design, height- and length-adjustable central armrest, steering wheel and leather trim with grey stitching on gear knob and handbrake lever and contrasting door interior trim.*











## Caddy – gjithmonë i pari.

Vendi i parë në: 'KEP Transporter of the Year', 'All- wheel Vehicle of the Year' por edhe fituesi i 'Best commecial Vehicle 2012', 'Flottenauto of the Year' si fituesi i 'Flottina Awards' flasin qartë për këtë model. Caddy® me 30 vite përvojë dhe 330 versione është makina e përkryer për heronjtë e përditshëm. Sepse heronjtë dinë të zgjedhin një partner tek i cili mund të mbështeten 365 ditët e vitit.
**Caddy. Vendos vazhdimisht standarde të reja!**

Ose zgjidhni financimin me këste. Për 377 Euro/muaj, ju përfitoni:
* 0% parapagim. * 30,000 kilometra në vit. * Targim dhe taksa regjistrimi. * Full Casco për territorin e Shqipërisë dhe jashtë (në rast se ky opsion kërkohet nga klienti). * Shërbimet periodike sipas kërkesave të prodhuesit. (Ndërrim vaji, filtrash vaji, ajri, kondicioneri, alkoolit të frenave etj). * Marrje dhe dorëzim i makinës për shërbime periodike në vendndodhjen e klientëve. * Zëvendësimin e gomave çdo 40,000 km. * Zëvendësim të makinës brenda 24 orëve, pa kosto, në rastet e riparimeve të mëdha. * Shërbim GPS për një kontroll të plotë të makinës tuaj. *Dhe shumë përfitime të tjera.

**Makina Tregtare**

---

Opsionet e makinës: Motor 1.6 TDI (naftë) 75 kf, ESP, ABS, ASR, mbyllje qendrore me pult, gomë rezervë, përgatitje për radio me 2 bokse, drita për udhëtim ditën, derë anësore, derë dopio për bagazhin etj.
Për informacion mbi ofertën na vizitoni në dy sallonet tona në Classic Sh.p.k dhe Porsche Albania ose në: +355 (0) 69 20 57 234.

SIMPLY CLEVER

ŠKODA




Konsumi i kombinuar dhe emetimet e CO2 të modelit Octavia: 3.8–6.1 l/100km, 99–141 g/km

Tek ŠKODA Octavia e re është shtuar shumë më tepër sesa thjesht hapësira. ŠKODA Octavia ofron një përvojë unike në udhëtim. Me dizajnin e ri, sa elegant aq edhe dinamik, makina është 102 kg më e lehtë gjë që e bën edhe më ekonomike në udhëtim. Teknologji të shtuara dhe të padukshme e shtojnë emocionin dhe sigurinë në çdo udhëtim tuajin. Tiparet e kësaj makine, vazhdojnë, e vazhdojnë... e vazhdojnë. Prandaj mënyra më e mirë për t'i njohur të gjitha është një test drive i personalizuar.

www.skoda-auto.al

Për më tepër na vizitoni në tre sallonet tona:

PORSCHE
ALBANIA
Autostrada Tiranë-Durrës km. 3, Tiranë,
Cel: +355 (0) 69 20 75 288,
E.: info@skoda-auto.al, www.skoda-auto.al.

E.T.T Group Auto Sh.p.k
Kthesa e Viroit, Gjirokastër
Cel.: +355 (0) 69 40 52 594
E.: ettgroupauto@gmail.com

KOSTANDIN
GROUP
Rruga Nacionale Shkodër-Tiranë
Cel.: +355 (0) 69 40 89 491
E.: info@kostandingroup.com